



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## VENDIMET E BORDIT TË FBK-së TË DATËS 13.03.2016

Bordi i Federatës së Basketbollit në mbledhjen e vet të mbajtur më 13.03.2016 ndër të tjera miratoi edhe këto

### VENDIME

1. Bordi e vlerësoi organizimin e IPKO Kupës si përgjithësisht të suksesshëm, me disa vërejtje të vogla dhe publikisht përshëndeti punën e bërë nga stafi i FBK-së në organizimin e këtij turneu.
2. Bordi vendosi që ndeshja All Star – Memoriali Isuf Lumi të zhvillohet në Mitrovicë në javën e parë të muajit prill. Bordi emëroi grupin punues në përbërje: Besim Braha, anëtar i Bordit, Leart Hoxha, Sekretar i Përgjithshëm dhe Arben Krasniqi, Menaxher i Përfaqësueseve, që të merret me detajet organizative të kësaj ngjarjeje.
3. Bordi miratoi propozimin që në muajin prill, në kohën e pushimit pranveror në shkolla të organizohet kampi nacional për basketbollistë e basketbolliste të grup moshës U14 e më të ulëta. Sekretari i Përgjithshëm u autorizua të dërgojë ftesën për një instruktor të FIBA-s dhe të merret me çështjet organizative.
4. Bordi u njoftua për përfundimin e sezonit të rregullt në Ligën e Parë dhe në Ligën e Femrave dhe kërkoi nga të gjithë të përfshirët në plejofet e ligave përkatëse sjellje korrekte, kurse nga gjyqtarët kërkoi vëmendje më të madhe dhe korrektësi maksimale.
5. Bordi miratoi propozimin që dy gjyqtarë potenciale për thirrje të gjyqtarëve të FIBA-s të marrin pjesë në klinikën për gjyqtarë në Sarajevë, kurse për gjyqtarët tjerë e la të hapur mundësinë që të dominohen nga FBK për klinikat tjera nëse shkojnë me vetë iniciativë dhe vetë financim.
6. Bordi u informua për situatën financiare dhe shkallën e zbatimit me Memorandumit të Bashkëpunimit me MKRS. Bordi mirëpriti alokimin e mjeteve për tre mujorin e parë nga MKRS dhe kërkoi që projektet në raport me MKRS dhe KOK të përmyllen me prioritet.
7. Bordi u njoftua për projektet TSSG dhe TCC, të cilat janë fituar si grante nga KON dhe do të zbatohen nëpërmjet KOK. Projekti TCC është zbatuar me sukses dhe në një kurs teknik për trajnerët kosovarë ka ligjëruar instruktori nga Sllovenia Tone Krump.

Në projektin TSSG, FBK ka siguruar grant prej 25,000\$ për përgatitje dhe pjesëmarrje në kualifikime për Eurobasket të reprezentacionit A.

**Kosovo Basketball Federation, Lagjja Arbëria, Objekti C2/11, Lokali nr. 4, 10000, Prishtina, Kosovo**  
**www.basketbolli.com, email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



TEB  
BNP PARIBAS JOINT VENTURE



kutia web agency





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

8. Bordi i FBK-së vendosi që turnetë finale të TEB Kupës së Kosovës për kategori të reja të zhvillohen në Mitrovicë (U16 dhe U18) dhe në Vushtrri (U12)

Erolld Belegu

Kryetar, Federata e Basketbollit e Kosovës



Kosovo Basketball Federation, Lagjja Arbëria, Objekti C2/11, Lokali nr. 4, 10000, Prishtina, Kosovo  
[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com), email: [info@basketbolli.com](mailto:info@basketbolli.com), tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



TEB  
BVP PARIBAS JOINT VENTURE



BAKER TILLY  
KOSOVO



TREGTIA  
[www.tregtia.net](http://www.tregtia.net)



RENAULT | automita



kutia web agency



digi  
print